

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Techno Resin” sh.p.k.

Sot, më datë 16.10.2024, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- Z. ANDI MINXOLLI, atësia Baftjar, amësia Dude, shtetas Shqiptar, lindur në Memaliaj dhe banues në TIRANË, me adresë: Rruga “ Perlat Rexhepi” Tiranë, lindur më 18/04/1973, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034666223 dhe nr. personal H30418194N;
- Z. ERDI KORMAKU, atësia Ergus, amësia Diana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë: Rruga e Kavajës, blloku i ambasadave, Tiranë, lindur më 12/08/1995, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033291868 dhe nr. personal J50812084C;

vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

Neni 1

Themelimi

1.1 Emri i shoqërisë është “Techno Resin” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “Shoqëria”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin.

Neni 2

Selia

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, e Regjistruar në ZRPP Tiranë, Zona Kadastrale 8220, Nr.Pasurisë 6/270, Tiranë.

2.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Objekti

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

A. Operacione industriale, tregëtare, financiare, civile, mobiliare, që kanë lidhje direkte apo indirekte me objektin tregëtar si dhe me objekte të ngjashme apo të lidhura me të, si dhe çdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kësaj shoqërie që janë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në fushën e tregëtisë import-export, me shumicë e pakicë, të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore e blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhim e tregëtim të materialeve të ndërtimit, inerte, rere, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara, të bimëve medicinale, të lëndës drusore, plastike, duraluminit, transport brenda dhe jashtë vendit. Aktivitetet në fushën e ndërtimit: punime dheu, sisteme, terracime, prodhim elementesh të parafabrikuara betoni e betonarme, dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, etj. Ndërtime rrugësh të kategorisë së V, IV, III, II, I dhe ndërtim fusha aviacioni, veshje me asfaltbeton të rrugëve, si dhe sistemim dhe asfaltim sheshesh, ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtim ujësjellesash dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji, prej betonarmeje dhe metalike, punime karpentierë metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinierike e hidogjeologjike, veshje fasadash. Rivelimet topografike, punime topogjeodezike, punime në sipërfaqe të gjelberta, parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese, instalimi i impianteve të ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjienike, instalimi i impianteve nën presion, restaurimi i ndërtësive monument kulture, punime restaurimi në veprat arkeologjike, ndërtime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje të sistemit hidraulik, cimentimet, kanale e impiante vaditjeje, punime karpentierë druri dhe metale, kabinetet e transformatoreve. Furnizim me resine dhe admix am 10, produkte të certifikuar nga BE. Punime me resine. Aplikim bojrash dekorative për ambiente të jashtme dhe të brendshme. Trajnim dhe kualifikim stafi për aplikimin e resinës në fushën e ndërtimit dhe bojrave dekorative.

B. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (Një qind mijë) Lek.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:

- **Z. Andi Minxolli**, 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 70,000 (shtatëdhjetë mijë lek), duke përfaqësuar 70% (shtatëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;
- **Z. Erdi Kormaku**, 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 30,000 (tridhjetë mijë lek), duke përfaqësuar 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;

5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7

Administratori

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Z. Erdi Ergus Kormaku**, shtetas Shqiptar, lindur më 12.08.1995, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit 033291868 nr.Personal J50812084C.

7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Statutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8

Viti Financiar

8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

8.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2024.


Neni 9

Të ndryshme

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKËT

Andi MINXOLLI



Erdi KORMAKU

Erdi Kormaku
